

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN-Departamenti i përgjithshëm, gjyqtarja e vetme gjykuese Sadije Selmani, me procesmbajtësen Ardijana Reshtani-sekretare juridike pranë kësaj gjykate, në lëndën penale kundër të akuzuarit S. G. nga Prizren, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.239-5/16 të datës 11.05.2016, për shkak të veprës penale, vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KP-së, në shqyrtimin fillestar, në prezencën e Prokurorit të Shtetit-Zejnulla Gashi dhe të akuzuarit, me datë 24.04.2017, mori dhe publikisht shpalli këtë:**

### AKTGJYKIM

#### I akuzuari:

S. G. nga i ati H. dhe e ëma B. e vajzërisë H. i lindur me në fshatin Komuna e R. tani jeton në Prizren, në rrugën " " ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, i martuar, baba i tre fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, me nr. personal

### ËSHTË FAJTOR

Se prej datës së pavërtetuar e deri me datë 17.11.2015, në banesën e tij, i akuzuari me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm për vete, e shfrytëzon energjinë elektrike në mënyrë direkte pa njëisor elektrik, që me qëllim që vetit ti sjellë pasuri të kundërligjshme, ka bërë shfrytëzimin e energjisë pa autorizim nga personat e autorizuar, e cila energji elektrike e shpenzuar nuk është regjistruar, me çka të dëmtuarës KEDS, Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me energji elektrike sh.a Distrikti në Prizren, i ka shkaktuar dëm në vlerë prej 201,48 €.

-Këso dore kryen veprën penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KP-së.

Andaj gjykata në kuqtim të nenit 4, 6, 7, 17, 41, 42, 46, 49 par.1 pika 1.1, 50, 51, 52, 73 dhe nenin 320 të KP-së, të akuzuarit ia shqipton:

### DËNIMIN ME GJOBË

Në shumë prej 150 € (njëqindpesëdhjetë euro), të cilën shumë i akuzuari duhet ta paguaj në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, e nëse i akuzuari nuk dëshiron apo nuk mund ta paguajë dënimin me gjobë, i njëjti do të zëvendësohet me dënim me burgim, ashtu që një ditë burgim llogaritet me njëzetë (20) euro gjobë, përkatësisht shtatë (7) ditë burg.

### DËNIMIN ME KUSHT

Duke ia vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muajve i cili dënim nuk do të ekzekutohet, nëse i akuzuari brenda afatit të verifikimit prej 1 (një) viti, nga flotfuqishmëria e këtij aktgjykimi, nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale.

E dëmtuara KEDS-Prizren, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

I akuzuari S . . . G . . . obligohet në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 20 euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

### Arsye t i m

Prokuroria Themelore në Prizren-Departamenti i Përgjithshëm, kësaj gjykate i ka parashtruar aktakuzën PP/II.nr.239-5/16 të datës 11.05.2016, kundër të akuzuarit S . . . G . . . nga Pr . . . për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 të KP-së. Pas leximit të aktakuzës prokurori i shtetit Zejnulla Gashi ka përmirësuar aktakuzën ashtu që në rreshtin e parë të përshkrimit faktik të aktakuzës, në vend të fjalës “në lokalin e tij” duhet të jetë “në banesën e tij”.

Në shqyrtimin fillestar, i akuzuari S . . . G . . . ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë sipas aktakuzës së PTH-së.

Gjykata në shqyrtimin fillestar ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Në tërësi u vërtetua, se i akuzuari S . . . G . . . prej datës së pavërtetuar e deri me datë 17.11.2015, në banesën e tij, i akuzuari me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm për vete, e shfrytëzon energjinë elektrike në mënyrë direkte pa njësor elektrik, që me qëllim që vetit ti sjellë pasuri të kundërligjshme, ka bërë shfrytëzimin e energjisë pa autorizim nga personat e autorizuar, e cila energji elektrike e shpenzuar nuk është regjistruar, me çka të dëmtuarës KEDS, Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me energji elektrike sh.a Distrikti në Prizren, i ka shkaktuar dëm në vlerë prej 201,48 €.

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari S . . . G . . . i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë, andaj edhe gjykata nuk ka administruar provat, sepse gjatë pranimit të fajësisë, gjykata konstatoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht dhe pa kushtëzim nga i akuzuari, pranimi i fajit mbështetet në faktet dhe provat që përmban aktakuza, për të cilat i akuzuari ka qenë i njoftuar me kohë dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e qenies së veprës penale të përshkruar si në shqiptim të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin të shpall fajtor dhe të gjykoj në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij..

Gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara si në nenin 73 të KP-së të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit. Prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë, se në procesin gjyqësor ka pas qëndrim korrekt para gjykatës, është familjar dhe mbajtës i vetëm i familjes, baba i tre fëmijëve, i pa punë dhe është hera e parë që ka rënë në kundërshtim me dispozitat ligjore. Kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimet e shqiptuara, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tyre dhe këto dënime të shqiptuara sipas bindjes së gjykatës janë në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari.

Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike është marrë konform nenit 463 par. 2 të KP-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, është marrë konform nenit 450 dhe 453 par.1 të KPP-së.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**

**P.nr.972/2016, me datë 24.04.2017**

**Procesmbajtësja**  
**Ardijana Reshtani**

**Gjyqtarja e vetme gjykuese**

**Sadije Selmani**



**UDHËZIM JURIDIKË:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.